# DËSHMI ARKIVI

**A-447313**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sadushi dhe Papajorgji në Romë, Mattarella konfirmon pjesëmarrjen në kongresin e drejtësisë në Tiranë - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/sadushi-dhe-papajorgji-ne-rome-mattarella-konfirmon-pjesemarrjen-ne-kongresin-e-drejtesise-ne-tirane/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 20:14:56 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 20:13:26 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4b3d69096f6ab9c6b82b1675f8f9d076e0be94d9fa28fb2b80a744ced02da15c` |
| TEKSTI | `3b72fe5d60668ccc603829ab261d5779aa0490e093644630a79a5ebd2019156e` |
| PAMJA | `b3845d4464cd7d2b29da30eca49f8502a1acb89152933f3fe269188704e57f01` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7de40dfc735804e041b091a57abfc297a2d247d1d273258615312225b1533918` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7de40dfc735804e041b091a57abfc297a2d247d1d273258615312225b1533918`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LAJMI I FUNDIT | VENDI

# Sadushi dhe Papajorgji në Romë, Mattarella konfirmon pjesëmarrjen në kongresin e drejtësisë në Tiranë

15 Shtator 2026 | 22:13

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Kreu i Gjykatës së Lartë, Sokol Sadushi, së bashku me kryetaren e Gjykatës Kushtetuese, Fiona Papajorgji, kanë zhvilluar një vizitë zyrtare në Romë, ku janë pritur në Palazzo del Quirinale nga Presidenti i Republikës Italiane, Sergio Mattarella.

Në aktivitet, ku mori pjesë edhe një delegacion i përbërë nga anëtarë të bordeve drejtuese të World Jurist Association dhe World Law Foundation, u diskutua për zhvillimin e edicionit të radhës të World Law Congress Albania 2027, i cili do të zhvillohet në Tiranë në muajin maj dhe do të mbledhë personalitete të drejtësisë globale.

Gjatë takimit u konfirmua zyrtarisht se Presidenti i Republikës Italiane, Sergio Mattarella, do të marrë pjesë si i ftuar nderi në këtë ngjarje, së bashku me Mbretin Felipe VI të Spanjës, si dhe autoritete të larta të institucioneve dhe drejtësisë ndërkombëtare.

Përzgjedhja e Shqipërisë për të organizuar një ngjarje të tillë prestigjioze përfaqëson një nder të veçantë për vendin, si dhe një dëshmi se puna, standardet dhe funksionimi i institucioneve të larta të drejtësisë dhe gjyqësorit po vlerësohen gjithnjë e më shumë nga partnerët ndërkombëtarë.

Ky besim nuk përbën vetëm një vlerësim për organizimin e një aktiviteti ndërkombëtar, por edhe një tregues të mënyrës se si institucionet shqiptare të drejtësisë perceptohen në marrëdhëniet me komunitetin juridik ndërkombëtar, si institucione me të cilat mund të ndërtohet dialog, bashkëpunim dhe partneritet në nivel të lartë.

Gjykata e Lartë, si bashkëorganizatore e WLC 2027, mbetet e përkushtuar në misionin e saj për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke garantuar që Shqipëria të jetë në lartësinë e pritshmërive për të pritur liderët e botës së drejtësisë në vitin 2027.

**Shiko në:**

## LAJMI I FUNDIT

22:06 **'Ish-krerët e UÇK-së meritojnë pafajësinë', Berisha: Nesër, sytë e shqiptarëve drejt Hagës**

21:56 **Rama drejt SHBA-së për Asamblenë e OKB-së, takime dhe me komunitetin shqiptar në Amerikë**

21:54 **"U bë gjysh katër herë", djali i Jakup Krasniqit flet nga Haga: Nesër presim pafajësi**

21:31 **Gazetari tregon çfarë pritet pas vendimit të Gjykatës së Lartë: Ky ishte treni i fundit për Veliajn**

[illegible] **"Nuk prisja që Veliaj të dilte nga burgu", Iljazaj: Ka ndjekur një strategji të gabuar**

21:13 **"Ndoshta do të të vrasin", batuta e Trump për kryeministrin kanadez pasi i dhuroi një çelës për në Shtëpinë e Bardhë**

TESTIM

## LAJME TË SUGJERUARA

LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | POLITIKË | VENDI

### Rama drejt SHBA-së për Asamblenë e OKB-së, takime dhe me komunitetin shqiptar në Amerikë

Kryeministri Edi Rama do të udhëtojë drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës më 19 shtator, ku do të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të...

21:56 | 15/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

### “U bë gjysh katër herë”, djali i Jakup Krasniqit flet nga Haga: Nesër presim pafajësi

Në një lidhje nga Haga për emisionin “Now me Erla Mëhillin”, gazetarja e Euronews, Esmeralda Mualaj, mori një intervistë me djalin e Jakup Krasniqit, Altin...

21:54 | 15/09/2026

EURONEWS ALBANIA | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | NOW ME ERLA MËHILLIN | POLITIKË | VENDI

### Gazetari tregon çfarë pritet pas vendimit të Gjykatës së Lartë: Ky ishte treni i fundit për Veliajn

Gazetari i Euronews Eni Ferhati foli në një lidhje direkte për emisionin “Now me Erla Mëhillin”, ku tregoi detaje nga seanca në Gjykatën e Lartë,...

21:31 | 15/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.